

VENDIM
Nr. 492, datë 26.6.2026

**PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PËRGJITHSHME TË KREDIVE TË REJA
PËR KATEGORITË PRIORITARE TË TË PUNËSUARVE PËRFITUES NË
ADMINISTRATËN PUBLIKE, PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 64/3 e 64/5, të ligjit nr. 23/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të kredive të lehtësuara për nëpunësit civilë dhe nëpunësit e tjerë të administratës publike, për vitin 2026, janë, gjithsej, 300 (treqind), me ndarjen, si më poshtë vijon:

- a) 70 kuota, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
- b) 70 kuota, Ministria e Mbrojtjes;
- c) 70 kuota, Ministria e Punëve të Brendshme;
- ç) 70 kuota, Ministria e Arsimit;
- d) 20 kuota, Ministria e Drejtësisë, për Policinë e Burgjeve.

2. Përfituesit sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, përzgjidhen në bazë kriterëve të parashikuara në sistemin e pikëzimit të përcaktuar në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Përfituesit sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, përzgjidhen në bazë kriterëve të parashikuara në sistemin e pikëzimit të përcaktuar në tabelën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Përfituesit sipas shkronjave “c” dhe “d”, të pikës 1, të këtij vendimi, përzgjidhen në bazë kriterëve të parashikuara në sistemin e pikëzimit të përcaktuar në tabelën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Përfituesit sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të këtij vendimi, përzgjidhen në bazë kriterëve të parashikuara në sistemin e pikëzimit të përcaktuar në tabelën nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Në rast se rezultojnë më shumë kandidatë me pikë të barabarta sesa kuotat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi dhe në tabelën bashkëlidhur, përzgjedhja e tyre realizohet sipas sistemit të pikëzimit të përcaktuar nga institucioni përfitues, për të realizuar numrin e kuotave të përcaktuara.

7. Punonjësit e administratës publike të përzgjedhur përfitojnë kredi të lehtësuara me interes 0%.

8. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

Tabela nr. 1: Pikëzimi për të punësuarit në administratën publike për t’u trajtuar me kredi të lehtësuara për blerjen e banesës për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

	KRITERET E PIKËZIMIT	100 pikë
1.1	Kushtet e strehimit	50
A	Nuk disponon banesë në pronësi	

B	Banon në një banesë të mbipopulluar, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	
C	Punonjës, që ka humbur banesën, si pasojë e zhvendosjes ose e zbatimit të një vendimi gjyqësor	
Ç	Punonjës, që banon në banesë, që do të priset, pasi përjashtohet nga procesi i legalizimit si rezultat i investimeve publike, si dhe nuk përfiton një banesë tjetër	
1.2	Kushtet familjare/sociale/punësimi	25
A	Punonjës, të cilët kanë jo më pak se dy vjet të punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit	
B	Punonjës, të cilët kanë jo më pak se shtatë vjet të punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit	
1.3	Kushtet ekonomike	25
A	I përkasin kategorisë së pagës sipas vendimit nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to	
B	I përkasin kategorisë së pagës IV-2, IV-1, III-1, sipas vendimit nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to	
C	I përkasin kategorisë së pagës II-2, II-1, I-5, I-4, I-2, sipas vendimit nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to	
Ç	I përkasin kategorisë së pagës, sipas vendimit nr. 424, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave	

Tabela nr. 2: Pikëzimi për të punësuarit në administratën publike për t'u trajtuar me kredi të lehtësuara për blerjen e banesës për Ministrinë e Mbrojtjes

	KRITERET E PIKËZIMIT	100 pikë
1.1	Kushtet e strehimit	50
A	Nuk disponon banesë në pronësi	
B	Banon në një banesë të mbipopulluar, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	
C	Punonjës, që ka humbur banesën si pasojë e zhvendosjes ose e zbatimit të një vendimi gjyqësor	
Ç	Punonjës, që banon në banesë, që do të priset, pasi përjashtohet nga procesi i legalizimit si rezultat i investimeve publike, si dhe nuk përfiton një banesë tjetër	
1.2	Kushtet familjare/sociale/punësimi	25
A	Punonjës, që i përket kategorisë “familje e re”, në kuptim të ligjit nr. 22/2018, të ndryshuar	
B	Punonjës, të cilët kanë jo më pak se dy vjet të punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit	
C	Punonjës, të cilët kanë jo më pak se pesë vjet të punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit	
1.3	Kushtet ekonomike	25
A	I përkasin kategorisë së pagës sipas vendimit nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to në vendimin nr. 420, datë 26.6.2024, të ndryshuar	
B	I përkasin kategorisë së pagës IV-2, IV-1, III-1, sipas vendimit nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to në vendimin nr. 420, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave	
C	I përkasin kategorisë së pagës II-2, II-1, I-5, I-4, I-2, sipas vendimit nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to në vendimin nr. 420, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave	

Tabela nr. 3: Pikëzimi për të punësuarit në administratën publike për t'u trajtuar me kredi të lehtësuara për blerjen e banesës për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, për Policinë e Burgjeve

	KRITERET E PIKËZIMIT	100 pikë
1.1	Kushtet e strehimit	50
A.	Nuk disponon banesë në pronësi	

B.	Banon në një banesë të mbipopulluar, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	
C.	Punonjës që ka humbur banesën, si pasojë e zhvendosjes nga zbatimi i një vendimi gjyqësor	
Ç.	Punonjës, që banon në banesë, që do të prishet, pasi përjashtohet nga procesi i legalizimit si rezultat i investimeve publike, si dhe nuk përfiton një banesë tjetër	
1.2	Kushtet familjare/sociale/punësimi	25
A	Punonjës, që i përket kategorisë “familje e re”, në kuptim të ligjit nr. 22/2018, të ndryshuar	
B.	Punonjës, i cili ka jo më pak se dy vjet i punësuar në administratën publike në momentin e aplikimit	
C.	Punonjësit, të cilët kanë jo më pak se shtatë vjet të punësuar në administratën publike, në momentin e aplikimit	
1.3	Kushtet ekonomike	25
A.	U përkasin në vlerë kategorive të pagës deri në III-1, sipas vendimit nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to	
A.1	U përkasin në vlerë kategorive të pagës mbi III-1, sipas vendimit nr. 325, datë, 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ose ekuivalente me to	

Tabela nr. 4: Pikëzimi për të punësuarit në administratën publike për t’u trajtuar me kredi të lehtësuara për blerjen e banesës për Ministrinë e Arsimit

	KRITERET E PIKËZIMIT	100 pikë
1.1	Kushtet e strehimit	50
A.	Nuk disponon banesë në pronësi	
B.	Banojnë në banesa në rrezik shembjeje, kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore	
C.	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	
Ç.	Familjet që humbasin banesën e tyre si pasojë e zhvendosjes ose e zbatimit të një vendimi gjyqësor	
D.	Banojnë në banesa, që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit si rezultat i investimeve publike	
1.2	Kushtet familjare/sociale/punësimi	25
A	Punonjësit arsimorë, të cilët, në momentin e aplikimit, janë të punësuar me kohëzgjatje të pacaktuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar	
B.	Familjet, ku të dy bashkëshortët (martesë e lidhur përpara nëpunësit të gjendjes civile) janë punonjës arsimorë	
C.	Punon jashtë vendbanimit mbi 100 kilometra larg dhe që qëndron në njësinë e vetëqeverisjes vendore (bashkisë), ku ndodhet institucioni publik i arsimit parauniversitar ku punon	
1.3	Kushtet ekonomike	25
A.	U përkasin kategorive të përcaktuara në lidhjen nr. 1, të vendimit nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar	
A.1	U përkasin kategorive të përcaktuara në lidhjen nr. 2, të vendimit nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar	